

VENDIM
Nr. 248, datë 11.12.2018

MBI MIRATIMIN E KONTRATËS NR. 116, DATË 20.11.2018 “PËR SHËRBIMIN E TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR TË LIDHUR NDËRMJET SHOQËRISË ‘ALBGAZ’ SHA DHE SHOQËRISË ‘ALBPETROL’ SHA, PËR PERIUDHËN 1.1.2018–31.12.2018”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 35 dhe nenit 36, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, VKM-së nr. 848, datë 7.12.2016 “Për krijimin e shoqërisë ALBGAZ sh.a.” dhe përcaktimin e autoritetit publik që përfaqëson shtetin si pronar të aksioneve të shoqërive: “ALBGAZ” sh.a. dhe “ALBPETROL” sh.a.”, si dhe nenit 15 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 11.12.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, për miratimin e Kontratës për shërbimin e transmetimit të gazit natyror të lidhur ndërmjet shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. dhe shoqërisë “ALBPETROL” sh.a., me nr. 116, datë 20.11.2018,

konstatoi se:

- Shoqëria “ALBGAZ” sh.a., me shkresën nr. 116/1 prot., datë 15.10.2018, protokolluar në ERE me nr. 392/3 prot., datë 16.10.2018, ka kërkuar miratimin e kontratës me nr. 116 prot., datë 2.10.2018, të lidhur ndërmjet shoqërisë “ALBPETROL” sha dhe “ALBGAZ” sh.a., për shërbimin e transmetimit të gazit natyror, për një afat njëvjeçar duke filluar nga data 1.1.2018–31.12.2018.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 229, datë 26.10.2018, ka filluar procedurën, për miratimin e Kontratës nr. 116, datë 2.10.2018 “Për shërbimin e transmetimit të gazit natyror të lidhur ndërmjet shoqërisë ALBGAZ sh.a. dhe shoqërisë ALBPETROL sh.a.”, për periudhën 1.1.2018–31.12.2018.

- Enti Rregullator i Energjisë me shkresën nr. 55/63 prot., datë 26.10.2018, ka bërë publikimin në median e shkruar dhe në përfundim të afatit, nuk rezulton të ketë pasur komente apo objeksione nga palët e interesit lidhur me këtë procedurë.

- Me shkresën nr. 392/4 prot., datë 31.10.2018, është njoftuar subjekti për vendimin e Bordit të ERE-s, mbi fillimin e kësaj procedure, si dhe i është kërkuar “ALBGAZ” sh.a. të bëjë në kontratë saktësimet si më poshtë:

- Në nenin 5, pika 5.1, të hiqen fjalët “palët bien dakord se çmimi i shërbimit të transmetimit...” pasi çmimi është i vendosur nga ERE me vendimin nr. 97, datë 23.4.2018, 28 lekë/m³ dhe për rrjedhojë, nuk është çmim i dakordësuar ndërmjet palëve, por është detyrues për palët.

- Në nenin 17, pika 17.1 në fund të paragrafit: “Të gjitha kushtet e kësaj kontrate konsiderohen thelbësore dhe mund të shtohen dhe/ose ndryshohen nëse vullneti i të dyja palëve është shprehur paraprakisht me shkrim” të shtohen fjalët: “të miratuar nga Bordi i ERE-s”.

- Të evidentohet dhe të plotësohet nga ana e ALBGAZ sh.a. sasia e gazit të parashikuar për t’u livruar, për periudhën e kontratës nga data 1.1.2018 deri më 31.12.2018.

- Në vijim të sa më sipër, shoqëria “ALBGAZ” sh.a., me shkresën nr. 116/2 prot., datë 20.11.2018, dhe e protokolluar në ERE me nr. 392/5, datë 20.11.2018, ka përcjellë bashkëlidhur kontratën me saktësimet e kërkuara nga ana e ERE-s. Në lidhje me kërkesën e tretë të shkresës së ERE-s nr. 392/4 prot., datë 31.10.2018, shoqëria “ALBGAZ” sh.a., ka reflektuar në kontratë në nenin 12, pika 12.4 sasinë e parashikuar për t’u livruar nga prodhuesi “ALBPETROL” sh.a. dhe transmetuar nga “ALBGAZ” sh.a., në sasinë 2.642.000 (dy milionë e gjashtëqind e dyzet e dy mijë Nm³ në muaj për periudhën 1.1.2018–31.12.2018).

- Objekti i kontratës midis shoqërive “ALBGAZ” sh.a. dhe “ALBPETROL” sh.a. është transmetimi i gazit natyror nga Shoqëria “ALBGAZ” sh.a., kundrejt një tarife transmetimi për llogari të shoqërisë “ALBPETROL” sh.a.

- Kjo kontratë rregullon të gjithë marrëdhënien e shërbimit të transmetimit të gazit natyror ndërmjet palëve duke përfshirë, por pa u kufizuar edhe programin, normimin, lëvrimin dhe pranimin e gazit natyror për periudhën kohore të përcaktuar në kontratë, me çmime të rregulluara nga ERE, në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 97, datë 23.4.2018 “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “ALBGAZ” sh.a., për vitin 2018.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë Kontratën nr. 116, datë 20.11.2018, “Për shërbimin e transmetimit të gazit natyror të lidhur ndërmjet shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. dhe shoqërisë “ALBPETROL” sh.a., për periudhën 1.1.2018–

31.12.2018” (bashkëlidhur).

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqëritë “ALBGAZ” sh.a. dhe “ALBPETROL” sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

